

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Junikut
Opština Junik – Municipality of Junik



KONTRATA

Titulli i tenderit: **Furnizim me dru për shkollat e Komunës së Junikut**

Numëri i prokurimit: **636-21-3176-1-3-6**

Numëri i brendshëm: **636-21-014-136**

Data: 06.07.2021

KOMUNA E JUNIKUT, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), e përfaqësuar nga U.D. **Udhëheqëse e Prokurimit**, Florinda Kukalaj në njëren anë; dhe N.T.SH Nazi Travel, Rr. Jakup Ferri nr. 15, 10000, Prishtine, Kosovë, me numër të biznesit dhe me numër fiskal 810094201, (në vazhdim "Operatori Ekonomik"), e përfaqësuar nga drejtori Bedri Murtezi, me numër të telefonit: 044 440 261 dhe email adresë: ntshnazitravell@gmail.com ne anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për: **Furnizim me dru për shkollat të Komunës së Junikut me numër identifikues: 636-21-3176-1-3-6.**

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë :

Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi njësi me TVSH	Shuma me TVSH
Dru për ngrohje për shkollën fillore "Edmond Hoxha"	m ³	150.00	35.95	5,392.50
Dru për ngrohje për gjimnazin "Kuvendi i Junikut"	m ³	80.00	35.95	2,876.00
Sharritja (e përshtatshme për ngrohje qendrore)	m ³	230.00	1.00	230.00
			TOTALI	8,498.50

1.2 Kontrata hynë në fuqi me datën: 06.07.2021 dhe përfundon me datën: 06.09.2021.

1.3 Afati kohor i përformancës nuk mund të jetë më shumë se 10 ditë nga data e marrjes së urdhërësës.

1.4 Vendi i dërgimit të furnizimeve do të jetë lokacioni i shkollave të Komunës së Junikut.

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: 8,498.50€; Tetë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e tetë euro e pesëdhjetë cent.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj secilën shumë të detyrimeve pas pranimit të secilës dërgese.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i furnizimeve duhet të jetë i përputhshëm me të gjitha aspektet të plotësuar specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të furnizimeve.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të

nënkontraktgjë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërrprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërprerë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkcontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënua nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtrua një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërrprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërprerë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Themelore në Pejë, dega Deçan në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.


E hartuar në gjuhën shqipe² në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik

N.T.SH Nazi Travel

Për Autoritetin Kontraktues

Komuna Junik

Emri:	Bedri Murtezi	Emri:	Florinda Kukalaj
Pozita:	Drejtor	Pozita:	U.D. Ldhëheqëse e Prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	06.07.2021	Data:	06.07.2021
Vula:		Vula:	

² Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga tenderuesi në tenderin e tij.

Aneksi 1.**SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME**

Për sigurimin e druve për ngrohje (Qarr- Bung të thatë, jo më shumë se 12 % lagështi) për shkollat fillore dhe të mesme pran Komunës së Junikut për vitin 2021 si dhe sharritja e tyre duhet të bëhet nga i njëjti operatore ekonomik.

Përshkrimi	Njësia	Sasia
Dru për shkollën fillore	m ³	150.00
Dru për gjimnazin" Kuvendi i Junikut"	m ³	80.00
Sharritja (e përshtatshme për ngrohje qendrore)	m ³	230.00
	Gjithsej	230.00 m ³

Operatori Ekonomik i pranon specifikmet e ANEKSIT 1 duke i nënshkruar dhe vulosur si në vijim:

Emri i Operatorit Ekonomik: N.T.SH."NAZITRAVELL"

Nënshkrimi:

Vula:



Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi njësi me TVSH	Shuma me TVSH
1	Dru për ngrohje për shkollën fillore "Edmond Hoxha"	m ³	150	35.95	5392.50
2	Dru për ngrohje për gjimnazin, "Kuvendi i Junikut"	m ³	80	35.95	2876.00
3	Sharritja (e përshtatshme për ngrohje qendrore)	m ³	230	1	230
				TOTALI	8498.50

